REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 183 prot. Kamëz, më 21.12.2022

**V E N D I M**
**Nr. 156. Datë 21 / 12 2022**
**MBI**
**"MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE TE KËSHILLIT BASHKIAK KAMËZ PËR VITIN 2023"**

**Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.12.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.138 Datë 19.12.2022**, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 3, pika ç, neni 51, neni 53, pika 2, dhe neni 54, si dhe rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak", me propozim të Kryesisë së Këshillit Bashkiak, duke pasur parasysh se hartimi i planit të aktiviteteve synon përcaktimin e një kornizë orientuese mbi punën dhe aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Kamëz duke pasur parasysh fuqizimin, ruajtjen e autonomisë se këshillit, si edhe siguron ushtrimin e funksionit legjislativ si organ përfaqësues, vendimarrës, mbikëqyrës e monitories, dhe se ky plan aktivitetesh është orientues dhe mundet të ndryshojë për çdo emergjencë, apo situatë të paparishikueshme në momentin e hartimit të tij, **Këshilli Bashkiak Kamëz";**

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Kamëz për vitin 2023, bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak Kamëz dhe Sekretari i Këshillit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**KRYETAR KËSHILLI**
**Hysen KOLDASHI**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

**Nr.138 prot.** **Kamëz, më 19.12.2022**

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr.138 Datë 19/12 2022**

**MBI**
**"MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK KAMËZ PËR PERIUDHËN JANAR 2023-DHJETOR 2023''.**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë "Qeverisja Vendore" e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" e ndryshuar , neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1 , gërma "b", të nenit 51, pika 3, nenit 54 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar dhe në zbatim të Rregullores së Funksionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, , Neni 119 "Programi i Punës së Këshillit Bashkiak" dhe sipas relacionit të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve, Kryetari i Këshillit i propozon Këshillit Bashkiak:

**TË MIRATOJË:**

1. Miratimin e programit të punës së Këshillit të Bashkisë Kamzë për periudhën Janar 2023 – dhjetor 2023, bashkëngjitur këtij projekt- vendimi.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij projekt-vendimi Këshilli Bashkiak Kamëz dhe administrata e Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**
**Nexhmije Topi**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**
**Hysen Koldashi**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

## PLANI I AKTIVITETIT TË KËSHILLIT BASHKIAK KAMËZ

### PROGRAMI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR 2023 – DHJETOR 2023

| Muaji | Lista e çështjeve | Nismëtar | Njësia përgjegjëse që ngarkohet për shqyrtim |
|---|---|---|---|
| **Janar** | 1. Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor. | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit<br>Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale |
| | 2. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat bashkisë, për muajin Janar 2022. | Kryetari Bashkisë | Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale |
| | 3. Raport mbi veprimtarinë 1-vjeçare të Këshillit Bashkiak Kamëz | Sekretari i Këshillit Bashkiak | Këshilli Bashkiak |
| | 4. Diskutime nga komuniteti | Këshilltarë e Qytetarë/OJF/Deputet | Administrata e bashkisë Kamzë |
| | 5. Mbledhje komisionesh të Këshillit | Këshilli Bashkiak | Këshilli Bashkiak |
| | 6. Mbledhja Plenare e Këshillit | • Kryetari Bashkisë<br>• Jo më pak se 1/3 Anëtarëve të KB<br>• Prefekti i qarkut | Këshilli Bashkiak |
| **Shkurt** | 1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe |

| Muaji | Lista e çështjeve | Nismëtar | Njësia përgjegjëse që ngarkohet për shqyrtim |
|---|---|---|---|
| | kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Shkurt 2022. | | Revizionimit<br>Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale |
| | 2. Informacion lidhur me daljet jashtë përdorimit të aktiveve të Bashkisë Kamëz. Këshilli del me vendim për këtë pikë. | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit |
| | 3. Me kërkesë të Këshillit Bashkiak, raport mbi auditimin e brendshëm të ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë për vitin 2021 (Ligji 68/2017 neni 48/6). | Këshilli Bashkiak | Kryetari Bashkisë<br>Administrata e bashkisë Kamzë |
| | 4. Diskutime nga komuniteti | Këshilltarë e Qytetarë/OJF/Deputet | Administrata e bashkisë Kamzë |
| | 5. Mbledhje komisionesh të Këshillit | Këshilli Bashkiak | Këshilli Bashkiak |
| | 6. Mbledhja Plenare e Këshillit | Kryetari Bashkisë<br>Jo më pak se 1/3 Anëtarëve të KB | Këshilli Bashkiak |
| Mars | 1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Mars 2022. | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit<br>Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale |
| | 2. Informim i Këshillit mbi "Parandalimin e dhunës me bazë gjinore". | Kryetari Bashkisë<br>Sektori i Shërbimit Social | Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale |
| | 3. Për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Kamëz për vitin 2022. | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

| Muaji | Lista e çështjeve | Nismëtar | Njësia përgjegjëse që ngarkohet për shqyrtim |
|---|---|---|---|
| | 4. Diskutime nga komuniteti<br><br>5. Mbledhje e komisioneve të Këshillit<br><br>6. Mbledhja Plenare e Këshillit | Këshilltarë e Qytetarë/OJF/Deputet<br><br>Këshilli Bashkiak<br><br>• Kryetari Bashkisë<br>• Jo më pak se 1/3 Anëtarëve të KB<br>• Prefekti i qarkut | Administrata e bashkisë Kamzë, Përfaqësues të KB<br><br>Këshilli Bashkiak<br><br>Këshilli Bashkiak |
| **Prill** | 1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Prill 2022.<br><br>2. Diskutime nga komuniteti<br><br>3. Mbledhje komisionesh të Këshillit<br><br>4. Mbledhja Plenare e Këshillit | Kryetari Bashkisë<br><br>Këshilltarë e Qytetarë/OJF/Deputet<br><br>Këshilli Bashkiak<br><br>• Kryetari Bashkisë<br>• Jo më pak se 1/3 Anëtarëve të KB<br>• Prefekti i qarkut | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale<br><br>Administrata e bashkisë Kamëz, Përfaqësues të KB<br><br>Këshilli Bashkiak<br><br>Këshilli Bashkiak |
| **Maj** | 1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Maj 2022.<br><br>2. Diskutime nga komuniteti<br><br>3. Mbledhje komisionesh të | Kryetari Bashkisë<br><br>Këshilltarë e Qytetarë/OJF/Deputet | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale<br><br>Administrata e bashkisë Kamzë |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

| Muaji | Lista e çështjeve | Nismëtar | Njësia përgjegjëse që ngarkohet për shqyrtim |
|---|---|---|---|
| | Këshillit<br><br>4. Mbledhja Plenare e Këshillit<br><br>5. Informim i Këshillit Bashkiak mbi "Raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të Bashkisë Kamëz të vitit 2022". | Këshilli Bashkiak<br><br>• Kryetari Bashkisë<br>• Jo më pak se 1/3 Anëtarëve të KB<br>• Prefekti i qarkut | Këshilli Bashkiak<br><br>Këshilli Bashkiak |
| **Qershor** | 1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Qershor 2022.<br><br>2. Diskutime nga komuniteti<br><br>3. Konstituimi i Këshillit<br><br>4. Zgjedhja e Anëtarëve të Këshillit të Qarkut. | Kryetari Bashkisë<br><br>Kryetari Bashkisë Administrata e bashkisë Kamzë<br><br>Këshilli Bashkiak<br><br>Këshilli Bashkiak | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale<br><br>Këshilli Bashkiak<br><br>Këshilli Bashkiak<br><br>Këshilli Bashkiak |
| **Korrik** | 1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Korrik 2022.<br><br>2. Diskutime nga komuniteti | Kryetari Bashkisë<br><br>Këshilltarë e Qytetarë/OJF/Deputet | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale<br><br>Administrata e bashkisë Kamzë |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

| Muaji | Lista e çështjeve | Nismëtar | Njësia përgjegjëse që ngarkohet për shqyrtim |
|---|---|---|---|
| | 3. Mbledhje komisionesh të Këshillit<br>4. Mbledhja Plenare e Këshillit | Këshilli Bashkiak<br>• Kryetari Bashkisë<br>• Jo më pak se 1/3 Anëtarëve të KB<br>• Prefekti i qarkut | Këshilli Bashkiak<br>Këshilli Bashkiak |
| Gusht | 1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë , për muajin Gusht 2022.<br>2. Diskutime nga komuniteti<br>3. Mbledhje komisionesh të Këshillit<br>4. Mbledhja Plenare e Këshillit<br>5. Përfaqësim institucional i Këshillit (në shoqatat përkatëse) | Kryetari Bashkisë<br>Këshilltarë e Qytetarë/OJF/Deputet<br>Këshilli Bashkiak<br>• Kryetari Bashkisë<br>• Jo më pak se 1/3 Anëtarëve të KB<br>• Prefekti i qarkut | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale<br>Administrata e bashkisë Kamzë<br>Këshilli Bashkiak<br>Këshilli Bashkiak<br>Këshilli Bashkiak |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

| Muaji | Lista e çështjeve | Nismëtar | Njësia përgjegjëse që ngarkohet për shqyrtim |
|---|---|---|---|
| **Shtator** | 1. Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Shtator 2022. | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit<br>Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale |
| | 2. Rishikim i Rregullores së Këshillit | Këshilli Bashkiak | Këshilli Bashkiak |
| | 3.Trajnime të Këshilltarëve në bashkëpunim me partnerë. | | |
| | 4.Mbledhje komisionesh të Këshillit | Këshilltarë e Qytetarë/OJF/Deputet | Administrata e bashkisë Kamzë |
| | 5.Mbledhja Plenare e Këshillit | Këshilli Bashkiak | Këshilli Bashkiak |
| | | • Kryetari Bashkisë<br>• Jo më pak se 1/3 Anëtarëve të KB<br>• Prefekti i qarkut | Këshilli Bashkiak |
| **Tetor** | 1. Për miratimin e familjeve përfituese te ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Tetor 2022 | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit<br>Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale |
| | 2. Trajnime të Këshilltarëve në bashkëpunim me partnerë. | Këshilli Bashkiak | Këshilli Bashkiak |
| | 3. Diskutime nga komuniteti | Kryetari Bashkisë | Administrata e bashkisë Kamzë |
| | 4. Mbledhje komisionesh të Këshillit | | Këshilli Bashkiak |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

| Muaji | Lista e çështjeve | Nismëtar | Njësia përgjegjëse që ngarkohet për shqyrtim |
|---|---|---|---|
| | 5. Mbledhja Plenare e Këshillit | Këshilltarë e Qytetarë/OJF/Deputet | Këshilli Bashkiak |
| | 6. Monitorimi i mbledhjeve konstituese të kryesive të fshatrave dhe ndërlidhësave Komunitar. | Këshilli Bashkiak | Këshilli Bashkiak |
| **Nëntor** | 1. Për miratimin e familjeve përfituese te ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë , për muajin Nëntor 2022 | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale |
| | 2. Këshilli informohet dhe diskuton raportin e përmbledhur, për 4-mujorin e dytë, (8-Mujor), mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës, të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë *(Ligji nr. 68/2017, neni 44/4).* | Kryetari Bashkisë Administrata e Bashkisë | Këshilli Bashkiak |
| | 3. Projekt planin vjetor të punës së Këshillit Bashkiak për vitin 2024 | Konferenca e Kryetarëve | Komisioni i Çështjeve Juridike |
| | 4. Trajnime të Këshilltarëve në bashkëpunim me partnerë | Këshilli Bashkiak | Këshilli Bashkiak |
| | 5. Këshilli merr nga Kryetari i Bashkisë projekt dokumentin përfundimtar të programit buxhetor afat-mesëm dhe të projekt-buxhetit vjetor. | Këshilltarë e Qytetarë/OJF/Deputet | Administrata e bashkisë Kamëz |
| | 6. Diskutime nga komuniteti | Këshilli Bashkiak | Këshilli Bashkiak |

| Muaji | Lista e çështjeve | Nismëtar | Njësia përgjegjëse që ngarkohet për shqyrtim |
|---|---|---|---|
| | 7. Mbledhje komisionesh të përhershëm të Këshillit | | |
| | 8. Mbledhja Plenare e Këshillit | • Kryetari Bashkisë<br>• Jo më pak se 1/3 Anëtarëve të KB<br>• Prefekti i qarkut | |
| **Dhjetor** | 1. Për miratimin e familjeve përfituese te ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6 % dhe fondi nga të ardhurat e bashkisë, për muajin Dhjetor 2023. | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit<br>Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale |
| | 2. Këshilli bën publik në faqen e interneti të Bashkisë projekt dokumentin përfundimtar të PBA-së dhe të projekt-buxhetit vjetor të depozituar nga Kryetari i Bashkisë. | Këshilli Bashkiak | Sekretari i Këshillit |
| | 3. Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kamzë për vitin 2023, si dhe projekt- buxhetin afatmesëm të bashkisë Kamzë për vitet 2023-2025. | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit |
| | 4. Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2022-2025 dhe buxhetit vjetor. | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit |
| | 5. Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Kamzës për vitin 2024. | Kryetari Bashkisë | Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit |

| Muaji | Lista e çështjeve | Nismëtar | Njësia përgjegjëse që ngarkohet për shqyrtim |
|---|---|---|---|
| | **6.** Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar dhe konvikteve të shkollave të mesme dhe profesionale, që plotësojnë kriteret për përfitimin e bursave dhe pagesave për vitin shkollor 2023-2024. | Kryetari Bashkisë | Komisioni i Arsimit, Rinise Kulturës dhe Sporteve |
| | **7.** Diskutime nga komuniteti | Këshilltarë e Qytetarë/OJF/Deputet | Administrata e bashkisë Kamëz |
| | **8.** Mbledhje komisionesh të Këshillit | Këshilli Bashkiak | Këshilli Bashkiak |
| | **9.** Mbledhja Plenare e Këshillit | • Kryetari Bashkisë<br>• Jo më pak se 1/3 Anëtarëve të KB<br>• Prefekti i qarkut | Këshilli Bashkiak |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 138 prot. Kamëz, më 19.12.2022

**PROJEKT - RELACION**

**PËR**

**"PROGRAMIN E DETAJUAR TË PUNËS SË KËSHILLIT**

**TË BASHKISË KAMËZ PËR PERIUDHËN JANAR 2023 – DHJETOR 2023"**

Të nderuar Këshilltarë,

Të nderuar Kryetarë të Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

Plani i Punës i Këshillit për periudhën Janar 2023– Dhjetor 2023, shoqëruar me planin e detajuar të konsultimeve dhe buxhetin e nevojshëm, është hartuar në mbështetje të nenit 54 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për Ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", Ligji nr. 68, datë 27.04. 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligje të tjera relevante me ndikim në funksionimin e qeverisjes vendore në përgjithësi dhe Këshillin Bashkiak në veçanti dhe rregulloreve specifike të miratuara në Këshillin Bashkiak Kamëz.

Në mbështetje të nenit 51/3, nenit 54 të ligjit 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe në zbatim të Rregullores së Funksionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, Neni 119 "Programi i Punës së Këshillit Bashkiak", në vijim propozojmë *"Planin e Punës të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2023– Dhjetor2023"*.

Ky program pune ka për qëllim të përcaktojë aktivitetet bazë mujore që do ndiqen nga Këshilli Bashkiak. Gjithashtu trajton në mënyrë të përgjithshme pikat e rendit të ditës të seancave plenare mujore, (por gjithmonë duke patur parasysh dokumentacionin që do të hartojë dhe do të paraqesë administrata e bashkisë KAMËZ), sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Ky relacion paraqet në formë të përmbledhur aktivitetet bazë të Këshillit Bashkiak, në përputhje me funksionet e veta dhe në shërbim të interesit të komunitetit bazuar në kuadrin ligjor në fuqi. Sa më sipër, bazuar në aktivitetet e bazë të Këshillit Bashkiak Kamzë janë llogaritur dhe shpenzimet për vitin 2023 që do të jenë 1.162.629 lekë.

Këto fonde do të detajohen nga Kryesia e Këshillit dhe më pas do të miratohen nga Komisioni Financës Taksave dhe Revizionimit.

Fondet do të miratohen nga Këshilli Bashkiak si pjesë integrale e buxhetit vjetor të Bashkisë Kamëz.

**PROPOZUES : KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**HYSEN KOLDASHI**